



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 28 prill 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit për Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Mbrojtjes për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarit

Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të Specializuar
Aleks Uajting

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II (“Trupi Gjykues”), në bazë të nenit 40(2) dhe (6)(h) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, dhe rregullave 9(5)(a) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara, lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 mars 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi mocion për pranimin e deklaratave të të akuzuarve (“Mocioni”).¹
2. Më 10 mars 2023, Mbrojtja e Hashim Thaçit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit dorëzuan bashkërisht kërkesë për zgjatjen e afatit për t’u përgjigjur.²
3. Më 16 mars 2023, Trupi Gjykues miratoi kërkesën e Mbrojtjes.³
4. Më 17 prill 2023, me kërkesë të Mbrojtjes së Hashim Thaçit,⁴ Trupi Gjykues gjatë seancës u miratoi të gjitha ekipeve të Mbrojtjes zgjatje të mëtejshme të afatit për dorëzimin e përgjigjeve ndaj Mocionit.⁵
5. Më 24 prill 2023, Mbrojtja e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit (“Mbrojtja”) dorëzuan përgjigjet ndaj Mocionit të ZPS-së.⁶

¹ F01351, Prokurori i Specializuar, *Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 8 mars 2023, me Shtojcën 1.

² F01364, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Përgjigjes ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 10 mars 2023.

³ F01378, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Përgjigjes ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 16 mars 2023.

⁴ F01458, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Përgjigjes ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 17 mars 2023.

⁵ Transkripti i seancës, 17 prill 2023, f. 2955-2957.

⁶ F01473, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Mocionit të ZPS-së për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 24 prill 2023, konfidenciale; F01474, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Thaçit ndaj Mocionit të Prokurorisë për me Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 24 prill 2023, konfidenciale; F01475, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Mocionit të ZPS-së për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 24 prill 2023, konfidenciale; F01476, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Mocionit të ZPS-së për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 24 prill 2023, konfidenciale.

6. Më 26 prill 2023, ZPS-ja dorëzoi kërkesë për zgjatjen e afatit për t'u kundërpërgjigjur ndaj përgjigjeve të Mbrojtjes ("Kërkesa").⁷

II. DISKUTIM

7. Në bazë të rregullës 76, pala ose pjesëmarrësi duhet të dorëzojë kundërpërgjigjen, nëse ka një të tillë, brenda pesë ditësh prej dorëzimit të përgjigjes. Trupi Gjykses mund të miratojë zgjatjen e afatit kur kërkesa parashtrohet në kohë, për t'i lënë Trupit Gjykses kohë të mjaftueshme për marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën para përfundimit të afatit përkatës. Në përputhje me rregullën 9(5)(a), pala që kërkon kohë shtesë duhet të demonstrojë arsye të vlefshme për zgjatje të afatit.

8. Sa i përket dorëzimit brenda afatit të Kërkesës, Trupi Gjykses vë në dukje se Kërkesa u dorëzua mjaftueshëm në kohë para përfundimit të afatit.

9. Sa i përket kriterit të arsyeve të vlefshme, ZPS-ja parashton se Kërkesa nuk dëmton Mbrojtjen, do të mundësojë kundërpërgjigje të fokusuara dhe të thjeshtuara, dhe përfundimisht shqyrtimin e Mocionit nga Trupi Gjykses. Në veçanti, përgjigjet e Mbrojtjes ngrenë aspekte të reja dhe komplekse faktike dhe ligjore, ndër të tjera për mënyrën si janë marrë deklaratat e propozuara, si dhe procedurën dhe kufizimet e pretenduara në lidhje me pranimin e tyre. Së fundi, ZPS-ja parashton se numri dhe gjatësia e deklaratave në fjalë, si dhe afatet që bien ndesh me njëri-tjetrin - arsye që më parë përlligjën zgjatje të afateve për Mbrojtjen – gjithashtu peshojnë në favor të miratimit të Kërkesës.⁸

10. Për arsyet e parashtuara nga ZPS-ja, dhe duke theksuar gjithashtu se Mbrojtja nuk kundërshtoi Kërkesën, Trupi Gjykses konstaton se kriteri i arsyeve

⁷ F01477, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatje të Afatit për t'iu Kundërpërgjigjur Parashtrimeve F01473, F01474, F01475, dhe F01476*, 26 prill 2023.

⁸ Kërkesa, para. 2.

të vlefshme përmbushet në këto rrethana. Gjithashtu, Trupi Gjykues gjykon se zgjatja e propozuar e afatit me një javë⁹ (d.m.th. deri më 8 maj 2023) është e arsyeshme.

11. Rrjedhimisht, Kërkesa miratohet.

III. VENDIM

12. Trupi Gjykues **MIRATON** Kërkesën dhe udhëzon ZPS-në të dorëzojë kundërpërgjigjen ndaj përgjigjeve të Mbrojtjes deri të hënën, 8 maj 2023.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E premte, 28 prill 2023

Në Hagë, Holandë.

⁹ Kërkesa, para. 1.